

**VENDIM**  
**Nr. 795, datë 19.12.2024**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT  
DHE KOMPETENCAT E KOMITETIT TË MBROJTJES DHE SIGURISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 36, të ligjit nr. 87/2024, “Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullore “Për mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
  2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, ministritë e linjës, institucionet e tyre të varësisë dhe Avokati i Përgjithshëm i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**

**RREGULLORE**

**PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE KOMPETENCAT E KOMITETIT TË  
MBROJTJES DHE SIGURISË**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë (në vijim KMS).

**Neni 2**

**Baza ligjore**

Komiteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë funksionon dhe ushtron kompetencat e tij në përputhje me ligjin nr. 87/2024, “Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij, si dhe me këtë rregullore.

**Neni 3**

**Stema dhe vula**

1. Komiteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë ka stemën dhe vulën e vet zyrtare.
2. Stema përbëhet nga stema e Republikës dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Komiteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë”, në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Vula zyrtare e KMS-së prodhohet, administrohet e ruhet, si dhe ka formën dhe elementet e përcaktuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## KREU II

### KOMPETENCAT, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMITETIT TË MBROJTJES DHE SIGURISË

#### Neni 4

#### **Kompetencat e Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë**

1. Përveç përgjegjësi të parashikuara në pikën 5, të nenit 36, të ligjit nr. 87/2024, “Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, KMS-ja ushtron edhe kompetencat, si më poshtë vijon:

a) vlerëson zhvillimin e investimeve të huaja në industrinë ushtarake, në zbatim të politikave shtetërore në fushën e mbrojtjes e të sigurisë, në rastet kur evidentohet prania potenciale e ndikimit të huaj;

b) garanton që zhvillimi i industrisë ushtarake të jetë në përputhje me objektivat afatgjatë të sigurisë dhe drejtimit e përcaktuara në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, përfshirë planifikimin për skenarë të mundshëm konfliktesh, parandalimin dhe iniciativat mbrojtëse strategjike;

c) vlerëson analizat e riskut për kërcënimet e mundshme, si: tensionet gjeopolitike, sulmet kibernetike, kërcënimet hibride, terrorizmin, duke garantuar që sistemet e sigurisë dhe planet e zhvillimit të armëve t’u përgjigjen këtyre kërcënimeve;

ç) vlerëson dhe orienton programet e zhvillimit në fushën e sigurisë dhe të industrisë ushtarake, duke u bazuar në rëndësinë strategjike, urgjencën e nevojës dhe ndikimin e mundshëm në sigurinë kombëtare;

d) vlerëson dhe orienton politikat për zinxhirin e furnizimit për komponentët kritikë ushtarakë, duke përfshirë lëndët e para dhe komponentët e teknologjisë së lartë, që janë thelbësorë për zhvillimin e sistemeve të reja të armatimit, që të jenë të sigurt e të qëndrueshëm;

dh) vlerëson implikimet etike të teknologjive të reja të armëve, si armët autonome, sistemet e inteligjencës artificiale dhe armët e shkatërrimit në masë. Komiteti mund të konsultohet me ekspertë ligjorë për etikën dhe organizata ndërkombëtare për të siguruar që zhvillimet në industrinë ushtarake të mos bien në kundërshtim me normat etike ose të drejtën ndërkombëtare;

e) miraton planin e masave për parandalimin, zvogëlimin e përballimin e risqeve dhe të kërcënimeve, që lidhen me infrastrukturën kritike, sigurinë kibernetike dhe interesa të tjerë të sigurisë kombëtare.

#### Neni 5

#### **Organizimi i brendshëm i Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë**

1. Veprimtaria dhe mbledhjet e KMS-së drejtohen nga kryetari.

2. Drejtori i përgjithshëm i KMS-së drejton dhe organizon veprimtarinë e sekretariatit teknik.

#### Neni 6

#### **Funksionet e kryetarit të Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë**

1. Kryetari i KMS-së ushtron kompetencat, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në rregullore.

2. Përveç sa parashikohet në dispozitat e legjislacionit në fuqi, kryetari i KMS-së:

a) vendos rastet në të cilat është e nevojshme pjesëmarrja e ministrave të tjera, përfaqësuesve të institucioneve apo të enteve të tjera shtetërore, përfaqësuesve të organeve të tjera shtetërore, ekspertëve, profesionistëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile, investitorëve apo personave të tjerë, pa të drejtë vote;

b) u cakton detyra institucioneve shtetërore, në funksion të ushtrimit të kompetencave të KMS-së;

c) i cakton detyra sekretariatit të KMS-së.

#### Neni 7

### **Organizimi i mbledhjeve**

1. KMS-ja mbledhet me kërkesë të kryetarit, sa herë vlerësohet e nevojshme nga kryetari, me qëllim mbrojtjen e garantimin e interesave në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe nxitjen e zhvillimit të industrisë ushtarake.

2. Në rastet kur është e nevojshme, në zbatim të ligjit ose kur shihet e arsyeshme, kryetari mund të thërrasë mbledhjet e KMS-së edhe jashtë radhe.

#### Neni 8

### **Rendi i ditës**

1. Mbledhjet e KMS-së zhvillohen në bazë të një rendi dite, të përcaktuar nga kryetari, me propozim të sekretariatit.

2. Në rendin e ditës përfshihen:

- a) çështjet e propozuara nga sekretariati dhe të miratuara nga kryetari;
- b) materialet bashkëlidhur për çdo çështje, që do të diskutohet në mbledhje.

3. Në raste urgjente, KMS-ja mund të vendosë edhe për çështje, të cilat nuk janë përfshirë në rendin e ditës.

#### Neni 9

### **Zhvillimi i mbledhjes**

1. Sekretariati teknik i KMS-së merr masat, duke njoftuar paraprakisht me shkrim, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjeve, anëtarët dhe personat pjesëmarrës, për thirrjen e mbledhjeve të KMS-së dhe për çështjet që do të diskutohen në to.

2. Institucionet përgjegjëse përgatitin dhe dorëzojnë pranë sekretariatit teknik materialet për rendin e ditës, të paktën 48 (dyzet e tetë) orë përpara zhvillimit të mbledhjes.

3. Në rastet kur gjatë mbledhjes trajtohet informacion i klasifikuar, zbatohen rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar.

4. Në mënyrë periodike organizohen mbledhje specifike për vlerësimin e raporteve të paraqitura nga institucionet përkatëse për zbatimin e detyrave të përcaktuara nga KMS-ja.

#### Neni 10

### **Kuorumi i mbledhjeve**

1. Mbledhjet e KMS-së janë të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij, një prej të cilëve duhet të jetë kryetari.

2. Vendimmarrja për mbledhjet e zhvilluara kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

#### Neni 11

### **Konflikti i interesit**

1. Në rastin kur një prej anëtarëve të KMS-së është në kushtet e konfliktit të interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ai nuk merr pjesë në vendimmarrje.

2. Anëtari i përjashtuar nga vendimmarrja, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk merr pjesë në mbledhje gjatë diskutimeve dhe votimit për çështjen, për të cilën është identifikuar konflikti i interesit.